

OSCAL 2020, edicioni i 7-të po vjen në Tiranë

16-17 Maj, Tiranë, Shqipëri

Open Source Conference Albania (OSCAL), konferenca e parë vjetore e këtij lloji në Tiranë, do organizohet për të shtatin vit radhazi për të promovuar **softuerin me kodburim të hapur, lirinë e softuerit, privatësinë në rrjet, të dhënat e hapura dhe dijen e hapur** në vendin ku jemi por dhe në rajon. OSCAL 2020 do të mbahet në datat 16-17 Maj në Tiranë dhe pritet të mbledhë mbi 300 pjesëmarrës të teknologjive të hapura, zhvilluesve, agjensive dhe profesionistëve të kulturë së lirë dhe të hapur, kriptoanakristëve dhe ëndërrimtarëve për një botë e më shumë liri në internet. Pjesëmarrësit do të bashkohen me besimin e përbashkët në një botë ku informacioni është i hapur, i lirë dhe i decentralizuar. Konferenca jo vetëm që i mundëson të gjithëve mundësinë për të ndarë njohuritë e tyre dhe eksperiencën me audiencën, por gjithashtu **frymëzon** të tjerët të bëhen pjesë e saj.

Një sërë prezantimesh dhe punëtorish do të mbahen në të dy ditët e konferencës. Më specifikisht, Cdo ditë nga ora 9:00 deri në 18:00, pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të njihen më tepër me tematika të ndryshme, po ashtu dhe të eksplorojnë mundësitë profesionale dhe për kontribute. Për më tepër do ketë dhe info booth nga komunitetet në të dyja ditët nga openSUSE, Mozilla, OpenStreetMap, Wikipedia, phpList dhe Nextcloud e të tjerë projekte me të cilat pjesëmarrësit mund të njihen më mirë.

OSCAL 2019 u mbyll me mbi 64 prezantime, folës nga vende të ndryshme të botës dhe mbi **300 pjesëmarrës** të frymëzuar për të vazhduar lëvizjen e softuerit të lirë edhe më tej. Pjesa më e bukur janë të gjitha komentet pozitive të cilat motivojnë organizuesit të vijnë gjithnjë me diCka më të madhe.

Tematika e këtij viti është: Liria e Internetit (*InternetFreedomFTW*)

Për vite, qytetarët e internetit kanë promovuar mjetet e bashkëpunimit të fuqizuara nga interneti dhe karakteri decentralizues i rrjetit të rrjeteve. Në të njëjtën kohë, haktivistët dhe gazetarët investigativ na kanë lajmëruar për rritjen e interesit në kontrollimin, filtrimin dhe censurimin e internetit siç e njohim ne.

Për fat të keq, frikërat tona më të mëdha po bëhen realitet. Ne lexojmë shumë e shumë raporte rreth asnjëanësisë së internetit që po humbet, operacionet e mbikëqyrjes masive që po kryhen, emrat e domaineve që po bllokohen, kanalet e lajmeve që po censurohen dhe qeveritë jtë cilat po luftojnë mjete si enkriptimi. Një fenomen shqetësues po ndodh në Shqipëri, Ballkan e gjithë botën. World Wide Web, një mjet mjet i rëndësishëm për të ndarë dijen, informacionin dhe një nga mjetet më të shpejta të komunikimit po përdoret kundër nesh dhe ne duhet të veprojmë!

Duhet të fillojë nga diku;

Duhet të fillojë ndojëherë;

Ku ka një vend më të mirë se OSCAL në Tiranë?

Ku ka kohë më të mirë se 16-17 Maj 2020?

OSCAL 2020: prezantime, punëtori, takime komuniteti dhe tavolina informuese për të na përgatitur për InternetFreedomFTW.

Në takim komuniteti i organizuar nga Open Labs Hackerspace, komuniteti lokal i dedikuar fuqizimit të kulturës së lirë dhe të hapur në Shqipëri që nga 2012.

Data të rëndësishme:

Thirrja për ligjërues: cfp.openlabs.cc/oscal-2020/cfp – deri më 01.04.2020

Thirrja për vullnetarë: hapet më 01.03.2020 - 14.04.2020

Thirrja për info-booths: hapet më 27.01.2020 - 01.04.2020

Regjistrimi për konferencën: 02.04.2020

Thirrja për sponsorë: <https://oscal.openlabs.cc/sponsors/>

Informacione të mëtejshme:

Website: oscal.openlabs.cc

E-mail: oscal@openlabs.cc

Rrjetet sociale:

Twitter: [@OSCALconf](https://twitter.com/OSCALconf)

Instagram: [@oscalconf](https://www.instagram.com/oscalconf)